

Data: 02.06.2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM-MONTIM DY ELEKTROPOMPA UJI PËR SISTEMIN E POMPIMIT TEK GALERITË E PJERRËTA TË EKSPANIT TË DIGËS, RINOVIMI I PANELIT TË KONTROLLIT, DHE FURNIZIMI NJË ELEKTROPOMPE THELLËSIE REZERVË PËR HEC KOMAN”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 51,489,917 (Pesëdhjetë e një milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 540,122.9 (Pesëqind e dyzet mijë e njëqind e njëzetë e dy pikë nëntë) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 02.06.2026 është 95.33 Lekë/Euro.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: *“Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43 pika a e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me termat e referencës dhe specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të

fondit limit. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlloritur të fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlloritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjisllacionit:

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Kjo përqindje është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e furnizimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë se operatori ekonomik ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve që kërkohen.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

✚ SSH EN ISO 9001 - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

✚ SSH EN ISO 45001 - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

**Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenit 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Autoriteti ka vendosur si kriter kualifikues kriteret e mësipërm pasi këto kriteret i japin sigurinë autoritetit kontraktor që operatori ekonomik fitues do përmbushë kërkesat për realizimin me sukses të kontratës së shpallur. Kërkesa në lidhje me këto certifikata mundëson një menaxhim të mirë të cilësisë dhe sigurisë së punonjësve. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë. Është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Konkretisht:**

✚ **SSH EN ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

✚ **SSH EN 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**SSH EN ISO 45001** - Ky standart kërkohet sepse vendos një sistem të strukturuar për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Duke qenë se kushtet ambientale të zonës ku do të instalohen dy elektropompat dhe linja e re e tubacionit të largimit të ujrave në galerinë e pjerrët konsiderohen të vështira, është e nevojshme të garantohet siguria dhe shëndeti i punonjësve gjatë proceseve të montimit. Qëllimi kryesor është të reduktojë aksidentet, të identifikojë dhe kontrollojë rreziqet në punë dhe të tregojë që kompania ka një sistem të organizuar për sigurinë e stafit.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, minimalisht për periudhën Mars 2026 - Maj 2026, jo më pak se 2 (dy) inxhinierë nga të cilët të paktën:

- ✚ 1 (një) inxhinier mekanik;
- ✚ 1 (një) inxhinier elektrik;

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i**

**kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomat e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Mars 2026 - Maj 2026.

### **Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike dhe termat e referencës për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

### **Konkretisht:**

Kërkesa se operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Mars 2026 - Maj 2026, jo më pak se 2 (dy) inxhinierë, nga të cilët të paktën 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier elektrik, është kërkuar pasi operatori ekonomik i cili do të realizojë këtë furnizim duhet të disponojë një minimum kapacitetesh burimesh njerëzore, në mënyrë që të tregohet se operatori ekonomik, zotëron mundësinë për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

✚ 1 (një) inxhinier mekanik - kërkohet pasi referuar temave të referencës dhe specifikimeve teknike, objekti i kësaj procedure prokurimi janë furnizim-montim dy elektropompa uji për sistemin e pompimit tek galeritë e pjerrëta të ekranit të digës, rinovimi i panelit të kontrollit, dhe furnizimi një elektropompe thellësie rezervë për HEC Koman.

Elektropompat janë makina me fluide punuese të cilat janë objekt studimi në inxhinierinë mekanike. Objekti i procedurës së prokurimit përfshin furnizimin e tre elektropompave dhe instalimin e dy prej tyre.

Elektropompat objekt i kësaj procedure janë pajisje të cilat duhet të porositen dhe të prodhohen në përputhje me parametrat/dimensionet/karakteristikat e kërkuara.

Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka kapacitetet e duhura të burimeve njerëzore, për të kuptuar specifikat e mallrave, dimensionet dhe parametrat e tjerë mekanikë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së mallrave me kërkesat teknike.

✚ 1 (një) inxhinier elektrik- Është kërkuar si kriter pasi pjesë e objektit të këtij prokurimi do të jetë dhe rinovimi i panelit të kontrollit dhe fuqisë për të gjithë elektropompat e galerisë së pjerrët. Rinovimi i panelit të kontrollit dhe fuqisë konsiston në përzgjedhjen, assemblimin dhe instalimin e komponentëve përbërës të panelit të ri sipas specifikimeve teknike. Ky proces kërkon njohuri dhe përvojë në disiplinën e inxhinierisë elektrike në mënyrë që të garantohet zgjedhja e elementëve/pjesëve përbërëse dhe assemblimit të panelit.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, minimalisht për periudhën Mars 2026 - Maj 2026, punonjësit teknik si më poshtë:

- ✚ 1 (një) saldator i çertifikuar me SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent;
- ✚ 1 (një) axhustator i çertifikuar me SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent;
- ✚ 2 (dy) montator;
- ✚ 1 (një) punonjës i çertifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH EN ISO 9712-2022 ose ekuivalent;

✚ Operatori ekonomik ofertues punonjësin e çertifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH EN ISO 9712-2022 ose ekuivalent, mund ta ketë këtë pjesë të stafit ose me kontratë bashkëpunimi.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

Për punonjësit e punësuar në stafin e tij, minimalisht për periudhën Mars 2026 - Maj 2026, duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën, minimalisht për periudhën Mars 2026 - Maj 2026;
- ✚ Çertifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuara me ligj.

Për punonjësin e çertifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH EN ISO 9712-2022 ose ekuivalent, nëse nuk rezulton në listëpagesat e shoqërisë, duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- ✚ Kontratë bashkëpunimi;
- ✚ Çertifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuara me ligj.

**Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me specifikimet teknike dhe termat e referencës për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

**Konkretisht:**

✚ Kërkesa se operatori ekonomik duhet të ketë në stafin për periudhën Mars 2026 - Maj 2026, minimalisht punonjësit teknik, është kërkuar pasi operatori ekonomik i cili do të realizojë këtë furnizim duhet të disponojë një minimum kapacitetesh burimesh njerëzore, në mënyrë që të tregohet se operatori ekonomik, zotëron mundësinë për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

✚ 1 (një) saldator dhe 1 (një) axhustator - Është kërkuar si kriter në mënyrë që operatori ekonomik ofertues të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimit dhe montimit të zërave për të cilat parashikohet të realizohen në këtë kontratë, në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe termat e referencës të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Pjesë e këtij prokurimi është instalimi i një linje të re tubacioni për largimin e ujërave nga galeria e pjerrët. Instalimi i linjës së re do të realizohet me tubacione çeliku të cilët do të lidhen më njëri tjetrin anë të saldimit. Për të realizuar këtë proces është e nevojshme të disponohen një saldator për të realizuar proceset e saldimit dhe një axhustator.

2 (dy) montator - Është kërkuar si kriter pasi montimi i suportëve mbajtës të tubacionit të linjës së re të largimit të ujërave dhe montimi i dy elektropompave në galerinë e pjerrët janë procese që kërkojnë njohuri dhe përvojë në disiplinën e montimeve mekanike. Për këtë arsye vlerësohet e nevojshme prania e dy montatorëve të cilët do të realizojnë këto procese.

✚ 1 (një) punonjës i çertifikuar për kontrollat NDT, sipas standartit SSH EN ISO 9712-2022 ose ekuivalent. Instalimi i linjës së re për largimin e ujërave nga galeria e pjerrët do të realizohet nëpërmjet aplikimit të procesit të saldimit. Duke qenë se kjo linjë do të ketë

rëndësi dhe duhet të garantohet cilësia dhe siguria e saj në garantimin e përballimit të presionit nominal të funksionimit, referuar praktikave më të përdorura në të tilla raste është e nevojshme që proceset e saldimit të kontrollohen më anë të aplikimit të metodave të testimit pa shkatërrim (NDT). Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të realizojë dhe të dokumentojë këto teste ose nëpërmjet stafit të vetë ose nëpërmjet bashkëpunimit me Specialist/subjekt të çertifikuar për kontrollet NDT.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, çertifikatë, deklaratë etj).*

**Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallit objekt prokurimi.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike.

*Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

**Argumentimi:**

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Katalogu teknik është një mjet thelbësor për të verifikuar që mallrat e ofruara janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të dokumenteve të prokurimit. Specifikimet teknike përfshijnë parametra të detajuar si përmasat, llojin e materialeve, kapacitetet, performancën dhe funksionalitetet e kërkuara për secilin produkt. Duke ofruar katalogun teknik, operatorët ekonomikë mund të sigurojnë që produktet që ofrojnë, plotësojnë këto kërkesa dhe mund të përdoren në mënyrë efektive për qëllimin e kërkuar.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me anë të këtyre deklaratave Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor , duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

Deklarata që mallrat duhet të jenë të rinj dhe të papërdorur është një masë e rëndësishme për të garantuar cilësinë, performancën dhe sigurinë e produkteve që ofrohen në kuadër të një procesi prokurimi. Kjo kërkesë mundëson që produktet të jenë të testuara dhe të certifikuara për përdorim të sigurt dhe të besueshëm, duke minimizuar rreziqet e defekteve, të keqfunksionimeve, dhe të shpenzimeve të papritura për riparime ose rinovime.

**2.3.8** Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Mjetet /Pajisjet   | Njësia | Sasia | Statusi             |
|--|--------|-------|---------------------|
| Pajisje për prerje   | Copë   | 2     | Pronësi ose me qera |
| Pajisje saldimi për elektroda çeliku ose pajisje saldimi MIG/MAG | Copë   | 1     | Pronësi ose me qera |

|   |      |   |                     |
|---|------|---|---------------------|
| Pajisje axhustimi                             | Copë | 1 | Pronësi ose me qera |
| Kamion me vinç me kapacitet ngritëse 1-1.5ton | Copë | 1 | Pronësi ose me qera |

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi/qira do të paraqiten këto dokumenta:

- a) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh, aktet e zhdoganimit ose faturë tatimore të shitblerjes orgjinale ose fotokopje e noteruar ose kontratë qiraje të noterizuar.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit. Kur janë në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni i automjetit, certifikata e kontrollit teknik.
- c) Për mjetet e siguruara me qira, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, i ndryshuar, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**Konkretisht janë kërkuar pajisjet dhe makineritë e mësipërme pasi:**

✚ Pajisje për prerje - Për të realizuar demontimin e elektropompës ekzistuese, demontimin e bazamentit të saj si dhe për të realizuar prerjet e nevojshme të tubacioneve sipas konfigurimit gjeometrik të galerisë së pjerrët është e nevojshme të përdoren pajisje për prerje të cilat mund të jenë elektrike DC, elektrike AC ose hidraulike.

✚ Pajisje saldimit për elektroda çeliku ose pajisje saldimit MIG/MAG - Realizimi i proceseve të saldimit të tubacionit të linjës së re të largimit të ujrave, suporteve të tubacionit dhe suportet e dy elektropompave të reja kërkon të domosdoshme posedimin e një pajisje për saldimit e cila mund të jetë për metodën me elektroda ose për metodën MIG/MAG.

✚ Pajisje axhustimi - Për të realizuar proceset e axhustimit të pjesëve të cilat do të saldohen është e nevojshme të përdoren pajisje për axhustim të cilat mund të jenë elektrike DC ose elektrike AC.

✚ Kamion me vinç me kapacitet ngritëse 1-1.5 ton - Për të realizuar transportin e mallrave dhe materialeve deri në HEC Koman është e nevojshme të përdoret një mjet transporti i përshtatshëm për sasinë dhe dimensionet gabarite të elektropompave, tubacioneve, etj vlerësohet si kriter minimal posedimi i një kamioncine. Për të realizuar shkarkimin e elektropompës së thellësisë në magazinën e HEC Koman dhe për të realizuar shkarkimin e dy elektropompave të galerisë dhe tubacioneve në sheshin në hyrje të galerisë së pjerrët është e nevojshme që automjeti i transportit të posedoj një vinc me kapacitet 1-1.5 ton.

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:*

Grupi i punës ka ndërmarrë procesin për hartimin e specifikimeve teknike për furnizim-montim dy elektropompave uji për sistemin e pompimit tek galeritë e pjerrëta të ekranit të digës, rinovim i panelit të kontrollit dhe furnizimi një elektropompe thellësie reserve për HEC Koman, ky proces bazohet në kërkesat specifike të HEC Koman me qëllim kryesor garantimin e sigurisë të veprës.

Duke qënë para faktit se, filtrimet e ujit nga rezervuari janë prezente, me anë të shtimit të pompave të reja, ri-integrimin e rrjetit dhe përmirsimin e procesit të kontroll-automatizimit synohet rritja e efikasitetit të sistemit të pompimit për largimin e filtrimeve. Ndërsa për sa i

përket, elektropompës së thellësisë ajo është një nyje kritike që shërben për të siguruar largimin e ujit në rast avarie në sallën e makinerive të HEC Koman.

Për këtë arsye, specifikimet teknike si dimensionet dhe parametrat nominalë janë nxjerrë duke marrë për referencë të drejtpërdrejtë paisjet/sistemet ekzistuese. Edhe pse në dokumentacionin teknik është shënuar identifikuar standardi teknik, grupi i punës saktëson së mbetet i hapur opsioni për variante ekuivalente të tij, me kusht që të plotësohen të njëjtat specifikime teknike dhe performancë.

Për identifikimin e saktë artikullit, është mundësuar paraqitja e të dhënave ilustruese përmes fotografive dhe skemave përkatëse, duke garantuar kështu njohjen e plotë me çdo specifikë të produktit të kërkuar përpara ofertimit.

### **Njësia e Prokurimit**